

KOMPETENCAT E MËSIMDHËNIES NË FUSHËN E KULTURËS DEMOKRATIKE ONLINE

*Për të drejtat tuaja,
drejt standardeve
evropiane*

Manuali i
mësuesit

Radmila Rangelov Jusović, PhD

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

KOMPETENCAT E MËSIMDHËNIES NË FUSHËN E KULTURËS DEMOKRATIKE ONLINE

Për të drejtat tuaja
drejt standardeve
evropiane

Manuali i mësuesit
Radmila Rangelov Jusović, PhD

© 2020 Këshilli i Evropës.

Të gjitha të drejtat të rezervuara.
Licencuar për Bashkimin Evropian sipas kushteve të caktuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, të riprodhohet apo të transmetohet, në asnjë lloj forme dhe në asnjë lloj mënyre, elektronike (CD – Rom, internet etj.) apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çdo sistem të ruajtjes apo rigjetjes së informacionit, pa lejen paraprake me shkrim nga Drejtoria e Komunikimeve (F-67075 Strasbourg Cedex or publishing@coe.int).

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Ky publikim është përkthim i versionit origjinal në gjuhën boshnjake që u botua me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të Bashkimit Evropian ose Këshillit të Evropës.

Botuar nga Këshilli i Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex
www.coe.int

© Këshilli i Evropës, prill 2020

Përmbajtja

PËR MANUALIN DHE KOMPETENCAT	5
Mësimi dhe mësimdhënia në distancë në situata të jashtëzakonshme	6
Si organizohet ky manual?	10
KREU 1. VLERAT	11
Pse është e rëndësishme të flitet për vlerat?	11
Pse kjo është e rëndësishme pikërisht tani?	12
Ide për veprimtari	13
KREU 2. QËNDRIMET	17
Pse është e rëndësishme të flitet për qëndrimet?	17
Pse kjo është e rëndësishme pikërisht tani?	19
Ide për veprimtari	20
KREU 3. AFTËSITË	25
Pse është e rëndësishme të flasim për aftësitë?	25
Pse kjo është e rëndësishme pikërisht tani?	27
Ide për veprimtari	28
KREU 4. NJOHURITË DHE TË KUPTUARIT KRITIK	33
Pse është e rëndësishme të flasim rreth njohjes dhe të kuptuarit kritik?	33
Pse kjo është e rëndësishme pikërisht tani?	35
Ide për veprimtari	36


PËR MANUALIN DHE KOMPETENCAT

Ky manual është krijuar në një kohë që nuk ngjason aspak me kohën që kemi njohur ne apo fëmijët tanë, në një çast kur rrugët dhe shkollat janë boshatisur, kur jeta është mbushur me frikë e pasiguri dhe kur sytë i kemi pasur të mbërthyer pas ekraneve televizive dhe rrjeteve sociale. Kjo është gjithashtu koha, kur më shumë se kurrë më parë, shumë njerëz po mendojnë edhe një herë për qëndrimet dhe për vlerat e tyre, si dhe për dijet dhe aftësitë.

Manuali flet pikërisht për **qëndrimet dhe vlerat** që duhet të kemi për ta ruajtur këtë botë si një vend të cilit i përkasim që të gjithë njëlloj, ku ndihemi të respektuar dhe të mbrojtur dhe ku lidhemi së bashku në komunitete të forta, të gatshëm për t'u përballur me çdo sfidë që na pret. Megjithatë, na duhen **njohuri të ndryshme, na duhet ta njohim botën dhe na nevojiten të tjera aftësi**.

Që të gjitha këto kërkojnë një sërë kompetencash, të cilat nuk i kemi të lindura, por që i mësojmë dhe i zhvillojmë, i ndryshojmë, i rishikojmë dhe i përditësojmë gjatë gjithë jetës.

Kuadri referencë i kompetencave për kulturën demokratike¹ është hartuar nga një numër i madh ekspertësh dhe profesionistësh e synon ofrimin e një kuadri orientimesh, brenda të cilave mund të eksplorojmë, të reflektojmë, e mbi të gjitha, për mënyrën si i rrisim dhe si i mësojmë fëmijët tanë, si në mjedisin familjar, ashtu dhe në shkollë apo në komunitet.



1. <https://www.coe.int/en/web/campaign-free-to-speak-safe-to-learn/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture>.

MËSIMI DHE MËSIMDHËNIA NË DISTANCË NË SITUATA TË JASHTËZAKONSHME

— Mësimi dhe mësimdhënia janë procese komplekse, që kërkojnë njohje të mirë të karakteristikave të zhvillimit të nxënësve. Të mësuarit, si një proces aktiv i realizimit të të kuptuarit të botës, përfshin qasje, metoda dhe strategji të ndryshme për një nxënie sa më të efektshme.

— Të mësuarit në distancë ka veçoritë e veta dhe, në kohën e zhvillimeve të vrullshme teknologjike, po bëhet gjithmonë e më i pranishëm në sistemet tona arsimore. Tashmë është vështirë të thuhet nëse e kemi gjetur përdorimin më të suksesshëm të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit ose ekuilibrin midis përdorimit të teknologjisë dhe ndërveprimit të pazëvendësueshëm real mes aktorëve në procesin e të mësuarit dhe të mësimdhënies.

— Ndërkohë që debatet për përdorimin e teknologjisë janë ende shumë të gjalla, e gjithë bota e ka gjetur veten në një situatë krejtësisht të re. Me mbylljen e shkollave, ndalimin e grumbullimeve dhe komunikimeve ballë për ballë, duhej të gjendej shpejt një zgjidhje për t'u përballur me këtë sfidë të re – si të ruhej procesi i mësimdhënies, si të ndihmoheshin nxënësit që të vazhdonin me nxënien dhe si të mbrohej shëndeti mendor i tyre.

— Vende të ndryshme kanë gjetur zgjidhje të ndryshme, qoftë përmes transmetimit të programeve shkollore në televizion, duke ulur në minimum komunikimin me nxënësit e duke pezulluar plotësisht procesin e mësimdhënies, po ashtu edhe përmes organizimit të mësimëve të përditshme në platformat dhe rrugët *online*. Nuk ka një zgjidhje ideale, sepse ne as nuk e dimë si mund të ishte ajo. Rezultatet e qasjeve të ndryshme dalin përmes analizave, të cilat, padyshim, do të kryhen pasi të përfundojë kriza.

— Nga ana tjetër, prindërit kanë marrë rolin e mësuesve. Ata janë shpesh të papërgatitur për t'u përballur me sfidat që u dalin përpara, për shkak se janë të zënë me punët e tyre, nuk i kanë njohuritë e mjaftueshme për t'i ndihmuar fëmijët ose janë të preokupuar për probleme sociale dhe ekonomike që prekin jetën e tyre.

— Sigurisht, është e qartë se rrugët dhe platformat e ndryshme për mësimdhënien *online* nuk mund të zëvendësojnë plotësisht, e aq më pak sa hap e mbyll sytë, procesin e zakonshëm të mësimdhënies. Është e qartë se mësuesit cilësorë janë gurët e themelit të një sistemi të mirë arsimor. Arsimit nuk do të thotë vetëm të mësosh, por edhe të socializohesh dhe të ndërveprosh me të tjerët.

— Futja e modeleve të reja të mësimdhënies ka sjellë një sërë problemesh, "gabime fillestarësh", si:

- ▶ Dhënia e detyrave të njëjta apo ndjekja e të njëjtit orar mësimesh, sikur nxënësit të ishin në shkollë, kjo i ka mbingarkuar nxënësit, prindërit e po ashtu mësuesit;
- ▶ Për hir të shpejtësisë dhe eficiencës, të njëjtat detyra dhe materiale u janë dhënë të gjithë nxënësve, pavarësisht dallimeve mes tyre;
- ▶ Mbështetja më shumë se duhet te teknologjia dhe mësimet *online*, ka bërë që nxënësit të shpenzojnë kohë më shumë seç duhet përballë ekraneve;

- ▶ Pamundësia për të gjetur rrugën dhe qasjet e vlefshme të monitorimit dhe të vlerësimit të ecurisë së nxënësve, pa pasqyruar aftësitë e tyre reale, e duke i frustruar ata;
- ▶ Ulja ose rritja më shumë seç duhet e pritshmërive të nxënësve – që nga mbingarkesa në përmbajtje deri te thjeshtimi më shumë seç duhet i detyrave;
- ▶ Pritshmëri jorealiste të prindërve dhe të mësuesve për të qenë në dispozicion në çdo çast;
- ▶ Mungesa e ndjeshmërisë dhe e shqetësimit në lidhje me shëndetin mendor të nxënësve, familjeve dhe mësuesve;
- ▶ Përrjashtimi i nxënësve që nuk kanë kushte të përshtatshme për të studiuar në shtëpi ose që nuk kanë akses në teknologji;
- ▶ Mosmarrja parasysh e gjendjes dhe zhvillimeve familjare.

■ Ky manual nuk ka për qëllim t’u japë përgjigje problemeve që kanë dalë apo të shtojë më shumë përmbajtje të re për mësuesit në orarin dhe ngarkesën e tyre që, edhe pa to, është më e zënë sesa duhet. Qëllimi i këtij manuali është të ndihmojë mësuesit (dhe prindërit), duke ofruar ide dhe shembuj konkretë veprimtarish që mbështesin zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe i ndihmojnë ata të kuptojnë më mirë botën rreth tyre e njëherësh të ruajnë shpresën dhe besimin se ata mund të ndërtojnë një botë më të mirë për veten, për të gjithë shoqërinë dhe për planetin. Ne nuk duhet ta humbim mundësinë për të diskutuar këto dhe tema të tjera me nxënësit. Nga njëra anë, ata janë vërtet të interesuar për këto tema e, nga ana tjetër, kjo është një mundësi ideale për të diskutuar në kohë reale qëndrimet dhe vlerat tona dhe për të fituar njohuri dhe aftësi të reja.

■ Ky manual bazohet në këto parime dhe supozime:

- ▶ Të mësuarit, duke përfshirë edhe të mësuarit në distancë, çka kërkon veprimtari që u mundëson nxënësve të bëjnë punë kërkimore të pavarur për të gjetur informacione, për të reflektuar dhe për të zgjidhur probleme;
- ▶ Çdo fëmijë është unik – secili ka dinamikat e veta dhe hapin e vet të punës, interesat dhe aftësitë e veta, si dhe rrethanat vetjake, kështu që të mësuarit duhet të diferencohet dhe të individualizohet;
- ▶ Të mësuarit varet jo vetëm nga aftësitë konjitive, por edhe nga motivimi, këmbëngulja, disiplinimi dhe mjedisi i shtëpisë, të cilat ndikohen shumë nga situata aktuale, duke kërkuar një nivel të konsiderueshëm fleksibiliteti;
- ▶ Përvetësimi i kompetencave për kulturë demokratike është një proces që kërkon kohë për të eksploruar, shqyrtuar e reflektuar dhe nuk është pjesë e ndonjë lënde apo mësimi të vetëm;
- ▶ Përvetësimi i këtyre kompetencave kërkon mbështetjen e mësuesve dhe të familjes, si edhe të personave të tjerë të komunitetit. Ky proces ndodh çdo ditë dhe në mënyra të ndryshme – çdo situatë jete përbën një mundësi për të mësuar.

TË MËSUARIT NË DISTANCË KËRKON VEPRIMTARI QË U MUNDËSOJNË NXËNËSVE TË KËRKOJNË NË MËNYRË TË PAVARUR INFORMACIONE, TË REFLEKTOJNË DHE TË ZGJIDHIN PROBLEME –

Të vënë në zbatim atë çka kanë mësuar dhe jo thjesht të riprodhojnë!

PO

- ▶ Shndërrojini materialet mësimdhënëse në njësi më të gjera dhe të integruara tematike – përqendrohuni te rezultatet kryesore.
- ▶ Krijoni detyra projektesh që të realizohen për periudha më të gjata kohore.
- ▶ Trajtojini nxënësit për mënyrat e përdorimit të strategjive të ndryshme të të mësuarit dhe ndiqni ecurinë e tyre.
- ▶ Ofrohuni burime online (faqe interneti, linqe, platforma të ndryshme).
- ▶ Nxitini që të kërkojnë në internet në mënyrë të sigurt.

JO

- ▶ Materiale të reja mësimdhënëse ose detyra të reja çdo ditë.
- ▶ Mësimet klasike me detyra që kërkojnë vetëm mbajtje përmendsh dhe riprodhim – duke u mbështetur vetëm te mësuesi.
- ▶ Lëndë të ndryshme që nuk lidhen me njëra-tjetrën dhe detyra çdo ditë.

NXËNËSIT KANË RRETHANA TË NDRYSHME VETJAKE, DINAMIKA DHE HAP TË NDRYSHËM TË PUNUARI DHE TË KUPTUARI TË PËRMBAJTJES – QASJA DHE DETYRAT NUK MUND TË JENË TË NJËJTA PËR TË GJITHË

PO

- ▶ Njohja e rrethanave ku jetojnë nxënësit dhe përshtatja sipas nevojave të tyre.
- ▶ Detyra javore të ndara në disa hapa – udhëzime me shkrim për çdo hap dhe shembuj të qartë, si dhe kriteret e suksesit.
- ▶ Ndjekje sistematike dhe dhënie vlerësimi.
- ▶ Detyra shtesë për ata që mbarojnë më shpejt.
- ▶ Detyra të personalizuara për fëmijët me aftësi të kufizuara.

JO

- ▶ Të njëjtat detyra, i njëjti hap dhe e njëjta dinamikë për të gjithë nxënësit.
- ▶ Video (TV) me detyra dhe shpjegime që janë të njëjta për të gjithë dhe që nuk mund të kthehen mbrapa apo të luhen përsëri.
- ▶ Detyra të paqarta që kërkojnë shumë mbështetje nga prindërit.
- ▶ Kërkesa teknike ose materiale që nxënësit nuk mund t'i përmbushin.

FËMIJËT KANË NIVELE TË NDRYSHME TË TOLERANCËS NDAJ IZOLIMIT, POR QË TË GJITHË NXËNËSIT PREKEN NGA RRETHANAT E JASHTME, KËSHU QË MUND T’I KUSHTOJNË VËMENDJE TË MËSUARIT NË PERIUDDHA MË TË SHKURTRA, TË KENË MË PAK AFTËSI PËR T’U PËRQENDRUAR APO VETËDISIPLINUAR, MË SHUMË STRES DHE MË SHUMË NEVOJË PËR AFËRSI

PO

- ▶ Jepuni nxënësve mbështetje dhe hapësirë, në mënyrë që të mund të flasin gjithmonë për gjithçka që ka rëndësi për ta – informojini vazhdimisht në mënyrën e duhur se çfarë po ndodh.
- ▶ Jini fleksibël – mos prisni të njëjtat gjëra nga të gjithë nxënësit.
- ▶ Prezantoni tema që flasin për emocionet dhe për mënyrat e menaxhimit të stresit; nxitini nxënësit që të shprehin lirshëm shqetësimet dhe frikërat e tyre.
- ▶ Ndhimojini që të ndihen krenarë për veten dhe që të shohin anën pozitive.
- ▶ Fillojini veprimtaritë duke u ofruar ndihmë, si për shembull: unë sot kam nevojë për ndihmë ... Jam pak i shqetësuar për ...
- ▶ Krijoni një sistem për ndjekjen e ecurisë së punës - raportim pas çdo hapi të realizuar; dërgimi i detyrave shokëve dhe shoqeve brenda një afati të caktuar; kujtojini për afatet e vendosura.
- ▶ Vendosni një sistem gjurmimi – një listë kontrolli për të ndjekur punën e nxënësve; simbole për çdo hap të përbushur, simbole me fytyra të qeshura, yje...
- ▶ Ndhimojini nxënësit që të vendosin një regjim të mirë pune, për të krijuar orare pune të përditshme, të përshtatura sipas vetë nxënësve dhe rrethanave të tyre të jetës.
- ▶ Nxisini te nxënësit interesin për veprimtari krijuese, leximin, artin, filmin...
- ▶ Mos ulni pritshmëritë nga nxënësit – ata duhet të ndihen se ju keni besim tek ata dhe tek aftësitë e tyre dhe se ata mund të arrijnë gjithmonë më shumë.
- ▶ Shpjegojuni nxënësve kriteret e vlerësimit të performancës së tyre – lëriini që ta vlerësojnë vetë veten.
- ▶ Ndiqni ecurinë e tyre dhe jepuni udhëzime të mëtejshme se si mund të përmirësohen.
- ▶ Udhëzoni se si mund të kërkojnë ndihmë.
- ▶ Ndhimojini që të përgatisin portofolin e tyre të punës.

SI ORGANIZOHET KY MANUAL?

Manuali përbëhet nga katër krerë që u kushtohen vlerave, qëndrimeve, aftësive dhe njohurive, si dhe të kuptuarit kritik. Në çdo krye jepen ide të ndryshme për veprimtaritë me nxënësit që mund t'ju ndihmojnë për forcimin e kompetencave të tyre për kulturë demokratike.

Ndonëse kompetencat e organizuara në të katërt krerët janë shumë të ndërlidhura dhe plotësuese të njëra-tjetrës, veprimtaritë duhet të përqendrohen në një prej tyre, duke mbajtur shënim edhe çfarë kompetencash të tjera mund të zhvillohen bashkë me të.

KREU 1: VLERAT



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË FLITET PËR VLERAT?

Demokracia dhe mjedisi demokratik në çdo vend mbështetet në vlera të caktuara, mungesa e të cilave kërcënon drejtpërdrejt thelbin e demokracisë.

— Këtu flasim për vlerat thelbësore, si: jeta njerëzore, dinjiteti njerëzor, barazia dhe drejtësia sociale. Prandaj, çdo shoqëri demokratike duhet të punojë vazhdimisht për zhvillimin dhe forcimin e këtyre vlerave, ndërkohë nuk duhet të harrojmë se kemi bërë rrugë të gjatë që sot t'i gëzojmë këto të drejta dhe vlera. **Demokracia dhe vlerat demokratike** sfidohen shpesh; për të gëzuar të drejtat dhe liritë, për shumicën e të cilave nuk jemi të vetëdijshëm, duhet të ndërmarrim hapa të rëndësishëm për t'i mbrojtur ato.

Vlerat

- Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe i të drejtave të njeriut
- Vlerësimi i diversitetit kulturor
- Vlerësimi i demokracisë, drejtësisë, ndershmërisë, barazisë dhe shtetit të së drejtës

— Ne besojmë se shkolla, si vendi ku ushqehet zemra dhe ku edukohet mendja, ka detyrimin dhe detyrën të hapë dialogun, të diskutojë dhe të mësojë vlerat që qëndrojnë në themel të shoqërive demokratike, të tilla si kompetenca, sepse vetëm nëse ato kuptohen dhe brendësohen plotësisht, marrin kuptimin që u takon. Sigurisht, këto vlera mësuesve duhet t'u paraqitet si një përmirësim i natyrshëm i veprimtarive ekzistuese me nxënësit. Në të vërtetë, shumica e mësuesve i shpjegojnë, japin modele dhe diskutojnë për vlera të ndryshme, duke qenë ose jo të vetëdijshëm për këtë. Megjithatë, ne duhet të theksojmë gjithmonë nevojën për **një mënyrë të planifikuar dhe të strukturuar** të të mësuarit dhe të diskutimit të këtyre vlerave.

Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe i të drejtave të njeriut

— Besojmë se të gjithë jemi dakord se çdo qenie njerëzore ka vlerë e dinjitet të njëjtë dhe si e tillë ka të njëjtën të drejtë për t'u respektuar e për të gëzuar një sërë të drejtash dhe lirish themelore njerëzore; për këtë arsye, qenia njerëzore duhet të trajtohet siç duhet. E kjo nënkupton se të drejtat e njeriut janë universale, të pandryshueshme, të pandashme dhe se ato vlejné për çdo njeri pa dallim; do të thotë se të drejtat e njeriut ofrojnë një sërë mbrojtjesh minimale të domosdoshme që qenia njerëzore të bëjë një jetë dinjitoze; do të thotë se të drejtat e njeriut ofrojnë themelin e rëndësishëm për liri, barazi, drejtësi dhe paqe.

Vlerësimi i diversitetit kulturor

— Paketa e dytë e vlerave bazohet në bindjen e përgjithshme se përkatësitë e tjera kulturore, ndryshimet kulturore, diversiteti dhe pluralizmi i pikëpamjeve, mendimeve dhe praktikave duhet të konsiderohen dhe të vlerësohen pozitivisht. Ky besim nënkupton se diversiteti kulturor është një aset për shoqërinë; se njerëzit mund të mësojnë dhe të përfitojnë nga shumëllojshmëria e perspektivave të ndryshme njerëzore; se diversiteti kulturor duhet të promovohet dhe të mbrohet; se njerëzit duhet të nxiten që të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, pavarësisht dallimeve kulturore të perceptuara mes tyre; se dialogu ndërkulturor duhet të shërbejë për zhvillimin e një kulture demokratike të jetuarit së bashku si të barabartë në shoqëri.

Vlerësimi i demokracisë, drejtësisë, ndershmërisë, barazisë dhe shtetit të së drejtës

— Paketa e tretë e vlerave bazohet në një sërë idesh për mënyrën se si duhet të funksionojë dhe se si duhet të rregullohet shoqëria, duke qenë të bindur se të gjithë qytetarët duhet të marrin pjesë në mënyrë të barabartë (qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur) në hartimin dhe në miratimin e ligjeve, që përdoren për rregullimin e shoqërisë; të gjithë qytetarët duhet të përfshihen në mënyrë aktive në proceset demokratike që funksionojnë brenda shoqërisë (kjo mund të nënkuptojë edhe mosangazhimin në raste të caktuara për arsye kundërshtimesh apo rrethanash të ndërgjegjshme); ndonëse vendimet duhet të merren nga shumicat, duhet të garantohet trajtimi i drejtë dhe i ndershëm i pakicave dhe personave që u përkasin pakicave. Drejtësia sociale, ndershmëria dhe barazia duhet të funksionojnë në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe shteti i së drejtës duhet të ekzistojë, në mënyrë që çdo person në shoqëri të trajtohet në mënyrë të drejtë, të barabartë, të paanshme dhe të ndershme sipas ligjeve të miratuara për të gjithë.

PSE KJO ËSHTË E RËNDËSISHME PIKËRISHT TANI?

— Kjo pandemi ka sjellë një sërë rregullash të reja sociale, si dhe ka ndryshuar tërësisht mënyrën e të jetuarit për shumicën prej nesh. Në kohë krize, shoqëritë priren t'i drejtohen vetëmbrojtjes e kjo është plotësisht e kuptueshme edhe në plan individual. Në këtë pikë, është e rëndësishme të jemi të sigurt që kemi një çati mbi kokë, kemi ushqim, të ardhura të garantuara etj. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që t'i përkasim diçkaje më të madhe se ne vetë dhe të ndihemi të mbrojtur dhe, në këtë rast, e gjithë vëmendja përqendrohet te sistemi dhe te shteti. Institucionet demokratike vazhdojnë të jenë demokratike përballë çdo lloj sfide. Por, në ekuacionin e demokracisë, edhe individit duhet të vazhdojë të qëndrojë brenda konceptit të ideve demokratike. Gjatë krizave të ndryshme, duke përfshirë edhe pandemitë, është shumë e rëndësishme të mos harrojmë të gjitha arritjet e njerëzimit, duke përfshirë edhe të drejtat e liritë e njeriut, që janë arritur për të gjithë, në bazë të rrethanave ose karakteristikave të individëve, pa diskriminim dhe pa dallim. Ne jemi dëshmitarë të kufizimeve të detyruara të disa të drejtave dhe lirive, si dhe "shkyçjes" së disa të drejtave të tjera ose të dhënies përparësi të drejtave të caktuara krahasuar me të drejta të tjera.

— Por ne, gjithashtu, duhet të reflektojmë për faktin se disa prej këtyre kufizimeve ndikojnë më shumë te disa individë (p.sh. izolimi dhe ndalimi i kontakteve fizike mund të jenë të papranueshme për personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë nevojë të veçantë për ndihmë), ndërkohë të njëjtat masa nuk ndikojnë njëlloj tek të gjithë individët. Kjo është një mundësi e përsosur, si dhe një detyrim për mësuesit/et, që t'i diskutojnë këto çështje të rëndësishme me nxënësit e tyre. Kjo është pjesë e përgjegjësisë, si pjesë e pandashme e kompetencave demokratike. Ne do ta gjejmë veten në dy role – si mbrojtës të demokracisë dhe si mësues apo edukatorë.



IDE PËR VEPRIMTARI

— Po ju paraqesim një sërë idesh të ndryshme që duhet të përshtaten sipas moshës dhe kontekstit të nxënësve. Këto ide rrjedhin nga besimi se është e rëndësishme që të flitet për vlerat, sidomos në këto kohë. Ju mund t'i përshtatni të gjitha këto ide dhe, në të vërtetë, duhet t'ua përshtatni moshës së nxënësve, mënyrës dhe stilit tuaj të të punuarit, rrethanave, lëndës që jepni etj.

— **Të flasim për vlerat:** filloni një cikël bisedash për vlerat me nxënësit tuaj. Nisuni nga premisa se nxënësit vijnë me disa vlera, të cilat i kanë mësuar që nga familjet e tyre. Po kështu edhe mësuesit. Si fillim, është shumë e rëndësishme që vlerat dhe kuptimi i tyre të mos lihen të nënkuptuara. Ju do të vëreni se gjithsecili kupton vlera të caktuara sipas mënyrës së vet. Është shumë e rëndësishme të mësohet se vlerat kanë kuptimet e tyre të veçanta, të cilat pasqyrohen në sjelljen e personit, sjelljet individuale tregojnë mënyrën se si materializohen vlera të caktuara, prandaj, sipas këtyre vlerave, kemi pasoja ose reagime ndaj sjelljeve. Për të nisur bisedën, filloni të flisni për vlerat e vetë nxënësve dhe çfarë kuptimi kanë ato vlera për ta. Përpiquni të përcaktoni vlerat e përbashkëta, duke respektuar në të njëjtën kohë të gjitha vlerat individuale.

— **Vlerat demokratike:** pandemia mund të jetë një mundësi për të diskutuar për vlerat demokratike. Si fillim, është e rëndësishme që nxënësit të mos paragjykojnë dhe të mos kufizohen. Së pari, diskutoni konceptin e demokracisë dhe jepuni mundësi nxënësve të përcaktojnë vlera të rëndësishme demokratike të çdo shoqërie. Hapi tjetër ka të bëjë me zbërthimin e vlerave individuale dhe rëndësinë e tyre në kohën e pandemisë. Si ruhet fryma demokratike e shoqërisë? Çfarë vlerash duhet të nxiten dhe ku duhet të fokusohemi (p.sh. kujdesi për të tjerët, përgjegjësi, shëndeti e të tjera)? Çfarë roli luajmë ne dhe si mund të kontribuojmë në krijimin e frymës demokratike, përmes të jetuarit me intensitet dhe theksimit të vlerave demokratike?

— **Nxitja e vlerave:** pas një diskutimi fillestar mbi vlerat, mund të kaloni natyrshëm në fazën tjetër, e cila, në teorinë e përvetësimit të vlerave, vjen pas përkufizimit konceptual – dhe ky është modelimi. Zgjidhni së bashku 20–25 vlera. Kërkojini çdo nxënësi të zgjedhë në mënyrë të rastësishme një prej këtyre vlerave, për të cilën ai/ajo do të punojë intensivisht për një periudhë të caktuar (një javë ose një muaj). Detyrat mund të konsistojnë në përpjekjet për të kuptuar se sa shpesh haset një vlerë e caktuar në media, si shfaqet ajo dhe si e perceptojnë nxënësit në jetën e tyre të përditshme, në familje dhe në shoqëri. Gjatë kësaj periudhe, nxënësit gjithashtu duhet të përpiqen të bëjnë sa më shumë gjëra

të mundin që të pasqyrojnë vlerën që ata kanë zgjedhur. Jepuni si detyrë që të përgatisin një prezantim e ta paraqesin atë para nxënësve të tjerë, në fund të kësaj periudhe.

■ **Të punuarit për vlerat e tyre:** vlerat kanë edhe rol motivues. Ato e nxisin personin të bëhet ashtu siç ai dëshiron. Sido që të jetë, shpesh vëmë re se nuk jetojmë sipas disa vlerave që i konsiderojmë të rëndësishme çdo ditë, për shkak se ato vihen vazhdimisht në sprovë nga mjedisi, personat e tjerë dhe situata të ndryshme. Kërkojuni nxënësve që të reflektojnë dhe të zgjedhin një nga vlerat për të cilën do të punojnë me kujdes. Skema mund të jetë si kjo më poshtë. Flisni me njëri-tjetrin se me cilën vlerë keni vendosur të punoni.

KJO VLERË ËSHTË E RËNDËSISHME PËR MUA

QËLLIMI IM ËSHTË

JA ÇFARË DO TË BËJ

■ **Të drejtat e njeriut gjatë pandemisë:** të drejtat e njeriut mbrohen në mënyrë të padiskutueshme nga disa konventa dhe deklarata, kushtetuta dhe ligje, sepse ato kërcënohen vazhdimisht. Këto të drejta përfshijnë, mes të tjerash, lirinë e njeriut dhe të drejtën e lirisë së lëvizjes, si dhe shumë të tjera. Megjithatë, gjatë pandemisë, të drejtat dhe liritë njerëzore kufizohen për shumë individë. Flisni me nxënësit për këtë temë. Ata duhet të përpiqen të identifikojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e individit që kërcënohen, si dhe të përpiqen të gjejnë bazën e vendimeve të tyre. Diskutoni me ta nëse këto vendime kanë kuptim. A janë respektuar të gjitha të drejtat e tjera të qenies njerëzore? Vendosini ato në kontekst së bashku me vlerat. Demokracia nënkupton detyrimisht edhe kritikën. Kjo është dhe arsyeja pse ne jemi qytetarë demokratikë, duke ngritur pikëpyetje për të mirën e përgjithshme.

■ **Krahasimet rajonale dhe globale të të drejtave dhe lirive të njeriut:** krahasimet bëhen me qëllimin për të gjetur faktorë të vlefshëm dhe për përhapjen, më pas, të praktikave më të mira. Kërkojuni nxënësve që të krahasojnë të drejtat dhe liritë e njeriut në vendin e tyre me vendet e tjera në rajon, si dhe të krahasojnë të drejtat dhe liritë e njeriut në vendin e tyre në nivel global. Do të vihet re se disa vende, si Suedia, kanë reaguar krejt ndryshe ndaj pandemisë. Edhe këtu, vendoseni këtë situatë në kontekstin e vlerave. Kërkojuni nxënësve që të analizojnë pyetjen: “Pse disa shoqëri demokratike në reagimet e tyre nuk kanë përfshirë masa ligjore kufizuese?”. Një nga çështjet më të rëndësishme është ajo e shëndetit tonë (për të gjithë brezat – më shumë vdekje ka pasur në grup-moshat mbi 65 vjeç – pse është e rëndësishme që të rinjtë të izoloohen), çështja e përgjegjësisë së shtetit për mbrojtjen e shëndetit, si dhe çështja e të drejtave ekonomike dhe sociale të njeriut.

■ **Stereotipat dhe paragjykimet:** në fillim të pandemisë, Kina dhe vende të tjera aziatike ishin pikat kryesore më të nxehta. Diferencimi racial ishte i dukshëm në aeroportet e gjithë botës e në vende të tjera dhe, madje, përfundimet nxirreshin në bazë të racës së personit. A është demokratike dhe e dobishme që njerëzit të diferencohen në bazë të ngjyrës së lëkurës apo të racës? Kjo është një mundësi shumë e mirë për të folur për stereotipat dhe paragjykimet ndaj të tjerëve që janë të ndryshëm nga ne. Diversiteti kulturor përbën gjithmonë terren të parapëlqyer për zhvillimin e stereotipave dhe paragjykimeve. Kjo ndodh zakonisht kur dimë pak ose aspak për dikë tjetër ose për kultura të tëra. Pyesni nxënësit çfarë dinë për kulturat lindore dhe për modelet e sjelljes. Është një mundësi shumë e mirë për të filluar bisedën rreth kulturave të ndryshme në një nivel të thelluar, si dhe për të diskutuar mbi stereotipat dhe paragjykimet që na çojnë shpesh drejt diskriminimit. Nuk është vlerë demokratike, apo jo?

■ **Le të njohim pak të tjerët:** ndonjëherë të tjerët jetojnë vetëm disa lagje larg nesh. Në zonat e prekura nga pandemia ka edhe komunitete të mëdha romë dhe kultura minoritetesh, të cilave pikërisht në kohë krizash nuk u kushtohet shumë vëmendje. Bashkë me nxënësit, mund të identifikoni minoritetet dhe grupet në nevojë që jetojnë në komunitetin tuaj. Si janë prekur ata nga pandemia dhe, në fund, çfarë mund të bëni për rregullimin e situatës? A keni ju anëtarë të këtyre komuniteteve në shkollën tuaj?

■ **Njihuni pak me shkollën tuaj:** kjo pandemi e ka ndryshuar jashtëzakonisht shumë të gjithë botën, duke përfshirë edhe sistemin arsimor. Shkolla tashmë është zhvendosur në ekrane dhe, ndonëse as nuk na shkon ndër mend, ka nxënës që nuk kanë akses në internet ose nuk kanë pajisjet e nevojshme teknike për të kryer mësimet *online*. Bëni kërkime në shkollën tuaj për nxënësit që janë prekur më shumë nga kjo situatë. Çfarë akti ndërgjegjësimi mund të bëni për të mos lënë pas asnjë fëmijë? Nëse jo të gjithë nxënësit kanë kompjuter, tableta dhe telefon, a gjeni ndonjë mënyrë që disa nxënës të punojnë me të njëjtat pajisje? A ka pajisje në laboratorin tuaj kompjuterik, që mund t'ua jepni këtyre nxënësve gjatë pandemisë? Megjithatë, jini të kujdesshëm. Mos i ekspozoni publikisht nxënësit që nuk kanë pajisje. Ju mund të realizoni disa veprimtari, si një "misioni tepër sekret", që të gjithë të ndihen mirë.

■ **Kontaktet me jashtë:** teknologjitë digjitale na japin larmi të papërshtueshme mundësish. Duke qenë se shumica e nxënësve dhe e shkollave janë të kufizuara, kjo është një mundësi e mirë për t'u njohur me të tjerët në mënyrë krejt të ndryshme. Zgjidhni një shkollë, në rajonin tuaj ose kudo në botë, për t'u lidhur *online* me nxënësit e së cilës mund të bëni këto veprimtari të përbashkëta. Mund të bëni mësimet të përbashkëta *online*, për të diskutuar kulturat tuaja dhe mënyrat kulturore, për të bërë projekte shkencore dhe projekte të tjera të përbashkëta. Aty ku fëmijët lidhen me njëri-tjetrin përmes mënyrash kuptimplota, këto marrëdhënie ruhen thuajse përgjithmonë.

KREU 2:

QËNDRIMET



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË FLITET PËR QËNDRIMET?

Qëndrimet demokratike përfshijnë tërësi idesh, besimesh e mendimesh në lidhje me diçka; ato përfshijnë ndjesi, vlerësime dhe, së fundmi, dëshirën për të vepruar në një mënyrë të caktuar. Pra, qëndrimet formësojnë sjelljen tonë dhe lidhen ngushtësisht me vlerat. Demokracia nuk mund të mbijetojë e vetme, prandaj, përveç institucioneve demokratike, demokracia ndërtohet dhe mbahet nga qytetarët që përbëjnë një pjesë të pandashme të saj. Ata i japin asaj legjitimitet dhe ligjshmëri dhe janë drejtpërdrejt përgjegjës për gjendjen e demokracisë. Në këtë ekuacion reciprok të demokracisë, institucionet demokratike garantojnë rregullat demokratike dhe një mjedis demokratik, ndërsa qytetarët garantojnë demokracinë në jetën e përditshme përmes sjelljes së tyre, kontributit dhe kritikave ndaj situatës. Shoqëritë demokratike janë edhe shoqëri pluraliste që garantojnë të drejtat dhe liritë e njeriut për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga karakteristikat e individëve. Megjithatë, qëndrimet duhet të mendohen mirë dhe pastaj të bëhen pjesë e brendshme e sjelljeve tona, në mënyrë që të jenë autentike dhe, ashtu si në rastin e kompetencave demokratike, reflektim i një fryme demokratike, kaq të nevojshme në të gjithë botën.

Qëndrimet

- Të jemi të hapur ndaj dallimeve kulturore dhe besimeve të tjera, pikëpamjeve dhe praktikave të ndryshme në botë
- Respekti
- Mendësia qytetare
- Përgjegjësia
- Vetëvlerësimi
- Toleranca ndaj paqartësive

— Është e një rëndësie jetësore që sistemet arsimore, shkollat dhe mësuesit të promovojnë qëndrime demokratike. Për më tepër, këto qëndrime duhet të kultivohen thellë në politikat arsimore dhe në punën e përditshme edukative me nxënësit. Respekti, fryma qytetare, përgjegjësia dhe vetefikasiteti janë postulatet bazë të çdo shoqërie demokratike. A nuk duhet që praktikats arsimore të jenë saktësisht në frymën e këtyre qëndrimeve? Përmes rritjes dhe edukimit të këtyre brezave, ne krijojmë themelin e shoqërive të ardhshme demokratike, që duhet të ngrihet mbi arritjet e reja demokratike dhe të kapërcejnë me sukses çdo sfidë që mund të hasin. Nxënësit tanë duhet të jenë në gjendje të ndërtojnë një shoqëri që i fuqizon ata me të drejtat dhe liritë e njeriut, pa përjashtim, dhe që krijon lidhje strukturore pozitive mes njerëzve, qytetarëve të përgjegjshëm që ndërtojnë komunitetet e tyre të vogla dhe të mëdha përmes mënyrash nga më të mirat e mundshme. Përgjegjësia dhe përgjegjësia morale, sidomos për sa i përket kësaj kompetence, mund të jetë një shtysë energjike për mendjet e zemrat e nxënësve tuaj.

■ Qëndrimi ka disa përbërës – mendimin apo besimin për diçka, emocionet apo ndjesitë, vlerësimin dhe, në fund, vullnetin për të vepruar në një mënyrë të caktuar. Gjashtë qëndrimet e përcaktuara në *Kuadrin e referencës për kompetencat e kulturës demokratike* janë si më poshtë:

- ▶ të jemi të hapur ndaj dallimeve kulturore dhe besimeve të tjera, pikëpamjeve dhe praktikave të ndryshme në botë;
- ▶ respekti;
- ▶ mendësia qytetare;
- ▶ përgjegjësia;
- ▶ vetëvlerësimi;
- ▶ toleranca ndaj paqartësive.

■ Ja edhe kuptimet e tyre:

Të jemi të hapur ndaj dallimeve kulturore dhe besimeve të tjera, pikëpamjeve dhe praktikave të ndryshme në botë

■ Është qëndrimi që kemi në ndaj njerëzve që perceptojmë se kanë përkatësi të ndryshme kulturore apo që kanë besime, pikëpamje dhe praktika që dallojnë nga tonat. Kjo përfshin ndjeshmërinë, kuriozitetin dhe vullnetin për t'u angazhuar me njerëz të ndryshëm dhe me perspektiva të tjera në botë.

Respekti

■ Me *respekt* kuptojmë aftësinë për të pasur konsiderata dhe vlerësime pozitive për dikë ose për diçka, duke u bazuar në gjykimin se ata kanë rëndësinë dhe vlerën e tyre të lindur. Të pasurit e respektit për persona të tjerë, që perceptohen se kanë përkatësi të ndryshme kulturore ose besime, opinione dhe praktika të ndryshme nga tonat, është shumë e rëndësishme për të ndërtuar dialogë ndërkulturorë të frytshëm dhe për kulturën demokratike.

Mendësia qytetare

■ Kjo kompetencë nënkupton qëndrimin ndaj një komuniteti apo një grupi shoqëror, të cilit i përket një person dhe që është më i madh sesa rrethi i familjarëve apo miqve të afërt të atij personi. Ajo përfshin ndjesinë e përkatësisë së komunitetit, ndërgjegjësimin e personave të tjerë në komunitet, ndërgjegjësimin për pasojat e veprimeve të një personi mbi pjesëtarët e komunitetit, solidaritetin me anëtarët e tjerë të komunitetit dhe ndjesinë e detyrës qytetare për komunitetin.

Përgjegjësia

■ Termi “përgjegjësi” ka disa kuptime. Dy kuptime që lidhen posaçërisht me kulturën e demokracisë janë: *përgjegjësia* si rol dhe *përgjegjësia morale*. E para është pjesë e mendësisë qytetare, ndërkohë këtu do të trajtojmë të dytën. Përgjegjësia morale është qëndrimi i një personi ndaj veprimeve të tij. Ajo lind kur një person ka detyrimin të veprojë në një mënyrë të caktuar dhe meriton vlerësim apo fajësim për kryerjen e veprimit ose për moskryerjen e tij në mënyrën e duhur. Kushtet që duhet të plotësojë një individ për t'u vlerësuar/lëvdur ose fajësuar janë: personi duhet të jetë në gjendje të reflektojë për veprimet e veta; të gjejë mënyrën se si do

të duhet të veprojnë për të përmbushur qëllimet; si dhe të jetë në gjendje të realizojë veprimet e zgjedhura (pra, kur mungesa e burimeve bashkë me kushtet strukturore nuk e lejojnë individin të kryejë një veprim të caktuar, nuk është e përshtatshme që ky person të lëvdohet ose të fajësohet). Përgjegjësia mund të kërkojë kurajë deri në atë masë sa mbajtja e një qëndrimi parimor mund të përfshijë edhe të vepruarin vetëm, ndërmarrjen e veprimeve që bien ndesh me normat e komunitetit apo qoftë edhe kundërshtimin e një vendimi kolektiv, që gjykohet se është i gabuar. Prandaj, ndonjëherë mund të ketë tensione mes mendësisë qytetare (interpretuar si solidaritet me personat e tjerë ose besnikëri ndaj tyre) dhe përgjegjësisë morale.

Vetëvlerësimi

— Vetëvlerësimi është qëndrimi ndaj vetes. Ai përfshin besimin pozitiv të personit tek aftësitë e veta, në ndërmarrjen e veprimeve të duhura për arritjen e qëllimeve të caktuara. Zakonisht, shkohet më tej e besohet se personi mund ta kuptojë çfarë kërkohet, mund të gjykojë në mënyrën e duhur, mund të përzgjedhë metodat e duhura për përmbushjen e detyrave, mund të kapërcejë me sukses pengesat, mund të ndikojë tek ajo çka ndodh dhe mund të bëjë dallimin në ngjarjet që ndikojnë te jeta e atij vetë dhe te jeta e personave të tjerë. Kështu, vetëvlerësimi shoqërohet me ndjesinë e vetëbesimit tek aftësitë e vetë personit. Një nivel i ulët vetëvlerësimi mund të shkurajojë sjelljet demokratike dhe ndërkulturore, edhe nëse personi ka një nivel të lartë aftësish, ndërkohë që një vetëbesim i lartë jorealit mund të çojë në frustrime dhe në zhgënjime. Qëndrimin optimal e përbën vetëbesimi relativisht i lartë, i kombinuar me një nivel të lartë dhe realist aftësish, që i inkurajon individët të marrin përsipër sfida të reja dhe u jep atyre mundësi të ndërmarrin hapa të mëtejshëm për çështje me interes për ta.

Toleranca ndaj paqartësive

— Toleranca ndaj paqartësive ka të bëjë me qëndrimin ndaj objekteve, ngjarjeve dhe situatave që perceptohen si të pasigurta dhe si objekt i konflikteve të shumta ose interpretimeve që nuk përputhen me njëra-tjetrën. Personat që kanë një nivel të lartë tolerance ndaj paqartësive, i vlerësojnë këto lloj objektesh, ngjarjesh dhe situatash, pozitivisht, janë të gatshëm të pranojnë mungesën e tyre të qartësisë, janë të gatshëm për të pranuar se këndvështrimet e personave të tjerë mund të jenë po aq të drejta sa edhe këndvështrimet e tyre, si dhe janë të gatshëm ta trajtojnë paqartësinë apo pasigurinë në mënyrë konstruktive. Prandaj, termi “tolerancë” këtu duhet të merret në kuptimin pozitiv, të pranimit e të përqaimit të pasigurisë ose të paqartësisë (dhe jo në kuptimin negativ, të durimit ose të tolerancës ndaj pasigurive e paqartësive). Personat me nivel të ulët tolerance ndaj pasigurive apo paqartësive i përmbahen një këndvështrimi të vetëm për situata dhe çështje të paqarta; ata mbajnë qëndrime mendjembyllura ndaj situatave dhe ndaj çështjeve të panjohura dhe e mendojnë botën si kategori fikse dhe jofleksibël.

PSE KJO ËSHTË E RËNDËSISHME PIKËRISHT TANI?

— Qëndrimet nuk janë thjesht besime apo mendime, opinione të ndryshme, ndjenja, vlerësime dhe, në fund, prirje për t’u sjellë në një mënyrë të caktuar ndaj një personi tjetër. Përveç kësaj, kur flasim për kompetenca e, në këtë rast, për kompetenca

demokratike, kemi parasysh larminë e vlerave **tona**, të qëndrimeve, të aftësive, të njohjes dhe të kuptuarit kritik. Pra, kemi parasysh qëndrimet **ndaj vetes** dhe jo thjesht ndaj të tjerëve. Ato janë të rëndësishme, sepse një qytetar, si një aktor në demokraci, mund të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin e demokracisë ose ta rrezikojë frymën e saj. Në këtë periudhë epokale të pandemisë, qëndrimet ndaj vetes marrin rëndësi të jashtëzakonshme. Të shpëtuarit e jetëve varet nga përgjegjësia dhe nga vendimi ynë për të qëndruar në shtëpitë tona. Vetëvlerësimi, por edhe toleranca ndaj pasigurive, nënkuptojnë që ne e kemi shndërruar shumë shpejt e qartë jetën, punën e detyrat tona në mënyra të reja të plotësimit të nevojave tona bazë. Kjo, gjithashtu, na ndihmon të përfitojmë sa më shumë nga kjo përvojë, si dhe të mësojmë aftësi e njohuri të reja. Veçanërisht në kohë pandemie, disa punë të caktuara, që nuk kanë pasur status shoqëror të posaçëm, tashmë po bëhen kryesore. Respekti ynë për profesione jashtëzakonisht të rëndësishme, si: mësimdhënia, mjekësia, gazetaria dhe industria e shërbimeve, tregon vlerat e vërteta të aseteve të ndryshme, në këtë rast, të vlerave njerëzore. Papritur, matricat tona kulturore dhe mënyrat e mësuara të sjelljes po pësojnë ndryshime dramatike. Tashmë, në planin social, nuk pranohet më shtrirja e dorës për të përshëndetur njerëzit apo angazhimi në veprimtari në grupe. Në këto kohë, është veçanërisht e rëndësishme të flasim, të mësojmë, të ngremë çështje për diskutime të theksojmë qëndrimet ndaj vetes, sepse pikërisht nga këto qëndrime vijnë edhe mënyrat tona të sjelljes. Është koha e qëllimeve të përbashkëta, solidaritetit dhe mirëkuptimit në mbështetje të së mirës së përbashkët. Është në dorën e mësuesve që t'i trajtojnë këto tema dhe koncepte me nxënësit e tyre si kurrë më parë, për hir të së ardhmes dhe frymës së demokracisë.



IDE PËR VEPRIMTARI

— Më poshtë jepen një sërë idesh të ndryshme, të cilat duhet të përshtaten sipas moshës dhe sipas kontekstit të nxënësve. Këto ide burojnë nga besimi se është e rëndësishme të flitet për qëndrimet, sidomos në situatat aktuale. Të gjitha idetë mund t'i përshtatni sipas mënyrës suaj të mësimdhënies.

— **Fillojmë me mua:** kështu mund të filloni me nxënësit temën e vetëvlerësimit. Me vetëvlerësim kuptojmë besimin pozitiv për aftësitë tona, për të ndër marrë veprimet e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të caktuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, po të mendojmë se jeta jonë ka ndryshuar në mënyrë të paimagjinueshme dhe secili prej nesh po përballlet me shumë trysni, thuajse me një situatë kaosi. Është çasti të mendojmë pak me vete, të sistemojmë pak jetët tona, që të jemi anëtarë të dobishëm të shoqërisë dhe të japim kontribut të drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës. Jepuni si detyrë nxënësve të hartojnë një listë, ku të shënojnë të gjitha detyrat dhe oraret e përditshme të veprimtarive dhe të rutinës së tyre, në mënyrë të tillë që të kuptojnë aftësitë dhe pikat e tyre të forta, të cilat i ndihmojnë në përmbushjen e këtyre detyrave. Si rezultat, nxënësit duhet të përgatisin një tabelë të qartë me të gjitha detyrat, por edhe me dëshirat dhe me gjërat që kanë pasur gjithmonë dëshirë t'i kryejnë, por nuk kanë gjetur kohë kurrë

më parë për t'i bërë. Diskutojmë së bashku. Mos harroni të përfshini edhe detyra të rëndësishme, si punë të vogla shtëpie apo familjare.

■ **Çasti kur mësojmë diçka të re:** të kesh shumë kohë të lirë ka përparësitë e veta. Jepuni nxënësve një listë detyrash të vështira, si p.sh.: *të mësojnë të hyjnë në kontakt me dikë në një gjuhë të huaj; të fillojnë të mësojnë një instrument muzikor; të lexojnë* etj. Kur ta keni gati listën e këtyre detyrave (të gjithë mund të kontribuojnë në këtë listë), kërkoni nxënësve që secili të zgjedhë një prej tyre. Në përfundim të një periudhe të caktuar kohore (në fund të semestrit apo muajit), kërkoni nxënësve të raportojnë mbi ecurinë e detyrës së ngarkuar. Nëse keni mundësi, nxënësit mund të punojnë së bashku në internet, sepse të rinjtë i merr malli për të qenë bashkë dhe për t'u shoqëruar. Jini kreativë në këto detyra. Pasionet e reja, njohuritë e reja dhe aftësitë e reja janë një mënyrë e shkëlqyer për të kaluar kohën e lirë. Bota virtuale është plot me kurse, seminare dhe trajnime falas. Mos harroni sigurinë në internet.

■ **Analizoni dhe veproni:** është koha për të reflektuar në mënyrë kritike, bashkë me nxënësit, për botën që na rrethon. Për fat të keq, shumë gjëra, që janë shumë të rëndësishme për jetën tonë, nuk funksionojnë. Analizoni së bashku problemet që jeni duke përjetuar apo ato që mund të identifikoni. Këtu mund të hasni sfida të ndryshme, që nga mungesa e pajisjeve teknike për nxënësit deri te furnizimi i të moshuarve në komunitet me artikujt e nevojshëm. Në çastin që keni identifikuar problemet, filloni t'i analizoni ato. Mund të përdorni **pemën e problemeve (problem tree)**, si një teknikë për të ndërtuar një lloj harte të shkaqeve dhe të pasojave. Edhe kjo teknikë gjendet *online*. Më pas, zgjidhni një problem, për të cilin nxënësit mund të japin kontributin e tyre.

■ **Unë veproj:** në pjesën më të madhe të komuniteteve ka organizata të shumta vullnetarësh, që bëjnë punë heroike gjatë pandemisë. Nëse nxënësit janë në moshë të përshtatshme, inkurajojini ata të hulumtojnë për mundësitë reale që të përfshihen në punë vullnetare dhe kështu mund të nisin një aventurë humanitare. Të rinjtë janë të privilegjuar dhe më pak të prekshëm nga virusi, prandaj aftësia për të lëvizur mund të shpëtojë dhe të lehtësojë mijëra jetë. Kryqi i Kuq, në mungesë të organizatave vendore, është një mundësi unike. Së fundmi, nxitini nxënësit që të fillojnë të krijojnë grupet e tyre informale që kujdesen për komunitetin.

■ **Si të përballemi me të panjohurën:** ju mund të diskutoni tema të shumta me nxënësit më të mëdhenj në moshë, si edhe me më të vegjlit, sepse bota nuk duhet të jetë një fakt i panjohur për nxënësit e çfarëdolloj moshe, kjo duhet paraqitur në mënyrën e duhur, që t'i ndihmojë ata të aftësohen. Tema në lidhje me virusin nuk duhet të shmanget, as me nxënësit më të vegjël, pasi ata kanë njohuri për çfarë po ndodh dhe është përgjegjësi e të rriturve që t'u japë siguri dhe mesazhe pozitive. Megjithatë, me nxënësit më të rritur në moshë, mund ta zgjeroni edhe më tej temën e diskutimit. Si të përballemi me të panjohurën. Përveç problemeve ekzistenciale, shoqëria jonë përballlet edhe me çështje të tjera, për të cilat nuk ka zgjidhje. Disa fabrika kanë vijuar punën dhe punëtorët janë të detyruar të qëndrojnë brenda dhe pranë njëri-tjetrit. Nxitini nxënësit që të mendojnë në mënyrë krijuese për të gjitha zgjidhjet e mundshme, për përmirësimin e sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës. Ky nuk është i vetmi shembull. Flisni pak për mbajtjen e zgjedhjeve, funksionimin e institucioneve dhe tema të tjera të ngjashme. Kërkoni zgjidhje prej tyre. Në fund,

bashkë me nxënësit, duke u mbështetur te përgjigjet e tyre, përpquni të krijoni një fushatë që shkon përtej kufijve të shkollës dhe të komunitetit tuaj.

■ **Merrni përsipër përgjegjësi:** çdo të thotë të jesh i përgjegjshëm në këtë çast? Flisni me nxënësit për përgjegjësinë e qëndrimit në shtëpi dhe për rëndësinë e respektimit të të gjitha rregullave. Kërkojuni atyre të krijojnë një tabelë me pikat e tyre të forta e të dobëta dhe, në vijim, të analizojnë të mirat që kemi nga respektimi i rregullave, si dhe pasojat që vijnë nëse i shkelim ato. Duke përdorur këto përfundime, mund të bëni një poster, një fushatë marketingu ose një reklamë.

■ **Kërcënimi i ri:** që nga çasti që shkollat u zhvendosën në kanale *online*, pasojat negative të internetit kanë dalë shumë më në pah. Është folur gjatë për sigurinë në internet, por tani, më shumë se kurrë, secili duhet të jetë i kujdesshëm. Filloni ta diskutoni këtë temë me nxënësit. Hulumtoni pak anët negative të internetit dhe për secilën prej tyre bëni një plan veprimi, të paktën, për klasën tuaj. Në qendër të diskutimit mund të jenë aplikacionet e ndryshme të sigurisë ose etika për sjelljet virtuale (*netiquette*), vini në punë imagjinatën. Mos harroni t'i ndani rezultatet me të tjerët. Lidhuni me klasa të tjera të shkollës suaj dhe bëhuni "ekspertë" të sigurisë virtuale. Mund të organizoni edhe një seminar të shkurtër virtual (*webinar*) për prindërit e nxënësve, si dhe për ata të klasave të tjera.

■ **Imagjinoni si duhet të jetë lloji i shkollës suaj:** nxënësit nuk janë fizikisht bashkë dhe mënyra e funksionimit të shkollës ka ndryshuar. Qëndrimi ndaj arsimit dhe diskutimet rreth tij përbëjnë një parakusht serioz për demokracinë. Kjo u jep mundësi nxënësve të kuptojnë dhe të analizojnë botën rreth tyre. Çfarë ka më shumë rëndësi se vetë jeta jonë?! Mësuesit duhet ta ndërmarrin këtë aventurë kureshtare dhe të fillojnë të bisedojnë me nxënësit për sistemin aktual të arsimit dhe për sistemin që do të dëshironin nxënësit të kishin. Bëjuni pyetje, të tilla si: "Shkolla që imagjinoj". Fillojini diskutimet me pyetje të ndryshme, si: "Çfarë njohurish dhe aftësish duhet të shpjegojë shkolla?"; "A është frekuentimi i shkollës e vetmja mënyrë për të mësuar dhe për të marrë arsim?"; "Çfarë duhet të ndryshojë në shkollë kur të ketë mbaruar pandemia?". Këto pyetje kanë për qëllim që nxënësit të shprehin pikëpamjet e mendimet e tyre për mënyrat alternative të mësimdhënies.

■ **Lajmet e rreme:** është krejtësisht e qartë, se shpërndarja e lajmeve të rreme përbën papërgjegjshmëri, ajo mund të përhapë panik mes shoqërisë dhe të shkaktojë dëme të paimagjinueshme. Çdo ditë qarkullojnë lajme që japin këshilla të rrezikshme për shëndetin, që ofrojnë teste false, medikamente false etj. Për një demokraci të shëndetshme, edukimi mediatik është shumë i rëndësishëm. Zhvillojeni si një projekt klase edukimin mediatik dhe mënyrat e dallimit të lajmeve të rreme. Sigurisht, jo gjithçka gjendet në këto projekte, pasi të menduarit kritik është parakusht i nevojshëm dhe mos e merrni si të mirëqenë. Aktivizoni nxënësit për të gjetur sa më shumë lajme të rreme dhe shpjegoni pasojat që mund të kenë ato. Një tjetër veprimtari mund të jetë hartimi i një formulari tip, që të dalloni lajmet e rreme për veten tuaj dhe për të tjerët në shkollë. A bëhet i ditur autori i lajmit? A është i dukshëm burimi i lajmit? A përmban lajmi argumente shkencore, të dhëna apo opinione? Ku është postuar: në rrjetin social *Facebook* apo në një portal mediesh? Çfarë janë standardet e gazetarisë? Çfarë do të thotë gazetari e përgjegjshme dhe e pavarur? Të gjitha këto janë pyetje interesante për edukimin mediatik.

■ **Mendësia qytetare:** në çastin që flasim, mijëra vetë janë të ekspozuar ndaj rrezikut për shkak të punëve të tyre dhe kjo gjë është shumë e rëndësishme për shoqërinë dhe, tek e fundit, për demokracinë. Ka punonjës në fushën e shëndetësisë, punonjës të dyqaneve dhe ushqimoreve, postierë mallrash dhe personel të transportit të pasagjerëve, zjarrfikës, policë, ushtarakë dhe shumë të tjerë. Bashkë me nxënësit, jo vetëm mund t'u dërgoni një letër falënderimi këtyre njerëzve, por edhe t'u shpjegoni qartësisht për çfarë u jeni mirënjohës. Kështu, nxënësit, pikë së pari, duhet të kuptojnë çfarë bëjnë këta punonjës dhe pse janë të rëndësishëm për momentin. Dërgimin e letrës mund ta shoqëroni edhe me dhurata simbolike me nxënësit, duke i treguar punonjësve se nuk janë vetëm e duke i inkurajuar të vazhdojnë punët e tyre shumë të rëndësishme.

■ **Temat që na presin:** edhe kjo do të kalojë. Sigurisht që bota nuk do të jetë e njëjta, por bashkë me kthimin te rutina dhe realiteti ynë, do të kthehen edhe temat tek të cilat përqendroheshim më parë. Pabarazia që ka ekzistuar, me shumë gjasë, do të jetë edhe më e dukshme pas pasojave shkatërruese të pandemisë. Jo vetëm pabarazia, por dhe të gjitha dukuritë me *"izma"* që ekzistojnë më parë, si: racizmi, nacionalizmi etj. Hulumtoni bashkë me nxënësit temën interesante të *"izmave në kohën e pandemisë"*. Virusi nuk zgjedh, kështu që të gjithë preken pavarësisht racës, gjinisë, besimit fetar apo orientimeve të tjera. Kërkojuni nxënësve të mendojnë se cilat prej këtyre *"dukurive"* kanë dalë në pah gjatë pandemisë dhe si mund të shfrytëzohet ky çast për të mbajtur ende parasysh këndvështrimet e reja sapo të mbarojë pandemia. Si mund të sigurohemi që solidariteti dhe të qenit të hapur ndaj të tjerëve të forcohet edhe më shumë në këtë botë.

KREU 3: AFTËSITË



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË FLASIM PËR AFTËSITË?

Nëse do të duhej të përshkruanim një person me të gjitha aftësitë që duhen për të krijuar, për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në zhvillimin e shoqërisë demokratike, lista do të ishte shumë e gjatë dhe, në pamje të parë, do të ishte e qartë se zhvillimi i këtyre aftësive kërkon punë të përditshme dhe përpjekje për të mësuar gjatë gjithë jetës. Të shënojmë disa prej tyre, si: aftësia për të mësuar,

për të menduar në mënyrë kritike dhe analitike, aftësia për të shfaqur simpati dhe për t'i kuptuar të tjerët, për t'iu përshtatur situatave të reja, për të bashkëpunuar me sukses, si dhe për të komunikuar dhe për të zgjidhur konflikte. Pa këto aftësi, sado të ndërlikuara dhe të vështira, jeta në një shoqëri demokratike dhe në ndërtimin e kulturës së demokracisë nuk do të ishte plotësisht e mundur.

— Megjithatë, të mësuarit e këtyre aftësive kërkon që mësuesit dhe profesionistët e tjerë të shërbejnë si model e të kenë kompetencat e duhura për t'ua mësuar të tjerëve këto aftësi. Megjithatë, nuk është gjithmonë kështu, prandaj puna me mësuesit dhe ofrimi i mbështetjes për profesionistët është çështje parësore. Përveç kësaj, ndonëse këto aftësi janë pjesë e deklaruar e pothuajse çdo programi shkollor, në praktikë shpesh është e paqartë se kur dhe si ua mësojnë dhe ua zhvillojnë mësuesit këto aftësi nxënësve në mënyrë efikase. Megjithatë, mundësitë për të mësuar këto aftësi dhe të tjera, nuk shprehen qartë. Ato mund të mësohen dhe të praktikohen çdo ditë, duke shtruar pyetje, duke bërë ushtrime në role, duke debatuar dhe duke diskutuar, duke kryer studime dhe projekte, duke punuar në grup, përmes përvojave dhe reflektimeve mbi përvojat e përfutuara. Dhe kjo gjë duhet bërë gjithmonë - në klasë, në veprimtari jashtëshkollore, në situata informale dhe biseda familjare, mes bashkëmohatarëve, mes angazhimeve në komunitet e më tej.

- Të mësuarit autonom të aftësive
- Aftësitë e të menduarit në mënyrë analitike dhe kritike
- Aftësitë e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit
- Empatia
- Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria
- Aftësitë komunikuese, gjuhësore dhe shumëgjuhësore
- Aftësitë e bashkëpunimit
- Aftësitë e zgjidhjes së konflikteve

Aftësitë

Të mësuarit autonom të aftësive

■ Të mësuarit e aftësive në mënyrë autonome na lejon ta organizojmë dhe ta vlerësojmë procesin tonë të të nxënies sipas nevojave tona, në një mënyrë të vetë-rregulluar dhe të vectorituar, pa u shtyrë nga të tjerët. Këto aftësi nënkuptojnë që ne jemi të vetëdijshëm për çfarë nuk dimë, që të mos i marrim gjërat lehtë, të dimë se si t'i verifikojmë dhe t'i gjejmë informacionet e rëndësishme dhe t'i vlerësojmë informacionet e gjetura. Që të mësojmë aftësi, duhet të dimë strategji të ndryshme mësimi, mënyra të ndryshme të organizimit, të krahasimit dhe të analizimit të informacionit, si dhe ta lidhim atë me pas me përvojën tonë. Në fund, duke reflektuar mbi procesin e të mësuarit, aftësohemi që të përmirësojmë të mësuarin, të menduarin dhe të arsyetuarin tonë.

Aftësitë e të menduarit në mënyrë analitike dhe kritike

■ Aftësitë e të menduarit në mënyrë analitike dhe kritike na japin mundësi të analizojmë, të vlerësojmë dukuri/fakte/gjëra të ndryshme dhe të arrijmë në përfundime apo opinione në mënyrë sistematike dhe logjike. Këto aftësi janë të ndërlidhura dhe komplekse dhe përmbajnë një sërë aftësish të tjera, që na mundësojnë të shohim përbërësit e fenomeneve të caktuara dhe marrëdhëniet mes tyre (analizë), të shohim marrëdhëniet mes shkakut dhe pasojës e t'i analizojmë ato, faktorët që ndikojnë tek to, të shohim pasojat e ndryshme, si dhe të nxjerrim konkluzione përmes një arsye-timi logjik. Këto aftësi na lejojnë që të përdorim gjykimin dhe pikëpamjet tona në lidhje me të dhënat e besueshme, fakte të provuara, si dhe të kuptojmë kontekstin dhe faktorët e tjerë që ndikojnë në to, duke përfshirë edhe vetë paragjykimet tona.

Aftësitë e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit

■ Me aftësitë e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit kuptojmë aftësitë e duhura për të kuptuar se çfarë thonë të tjerët dhe për të mësuar nga sjellja e personave të tjerë. Që të kuptosh se çfarë thonë të tjerët, është i nevojshëm të dëgjuarit aktiv – të ndjekësh me vëmendje jo vetëm çfarë thuhet, por edhe si thuhet, duke përdorur logjikën e gjykimin dhe të argumenteve, si dhe duke kuptuar kontekstin shoqëror dhe kulturor të komunikimit.

Empatia

■ Empatia përfshin një sërë aftësish që nevojiten për të kuptuar të tjerët, ndjenjat, mendimet dhe besimet e tyre, si dhe për ta parë botën nga këndvështrimi i tyre.

Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria

■ Me fleksibilitet dhe përshtatshmëri kuptojmë aftësitë e nevojshme për t'i përshtatur mendimet ose mënyrën e të menduarit, ndjenjat ose sjelljet sipas konteksteve dhe situatave të caktuara, me qëllim që të reagojmë si duhet e në mënyrë efektive ndaj sfidave, kërkesave ose mundësive të reja. Për ta bërë këtë, duhet të jemi të gatshëm t'i rishikojmë mendimet tona, të jemi të hapur ndaj pikëpamjeve të reja, si dhe të jemi të gatshëm për të ndryshuar sipas informacioneve dhe argumenteve të reja. Që të jesh i hapur ndaj risive, duhet të përshtatesh dhe të kapërcesh me sukses emocione dhe mendime të caktuara, që na shkaktojnë frikë ose paretë.

Aftësitë komunikuese, gjuhësore dhe shumëgjuhësore

— Aftësitë komunikuese, gjuhësore dhe shumëgjuhësore janë aftësi që na nevojiten për të komunikuar si duhet dhe në mënyrë efikase me personat e tjerë në situata, kontekste dhe kultura të ndryshme. Shprehja e mendimeve, bindjeve dhe nevojave, duhet bërë përmes argumentesh të forta në diskutime, debate, negociata etj., duke mos imponuar pikëpamjet tona dhe pa hyrë në konflikte. Këtu përfshihet aftësia për t'u përshtatur me kontekste të ndryshme linguistike dhe kulturore, për të bërë pyetje për sqarim apo përmbledhje, si dhe aftësi të tjera të nevojshme, duke përfshirë dhe meditimin, për t'u kuptuar me njëri-tjetrin. Duhet të përqendrohemi te forca e argumentit, jo tek argumentet e forcës.

Aftësitë e bashkëpunimit

— Aftësitë e bashkëpunimit përfshijnë aftësitë e nevojshme për të bashkëpunuar me sukses me të tjerët në veprimtari, detyra dhe ndërmarrje të përbashkëta. Me qëllimin për të realizuar bashkëpunime të suksesshme, njerëzit duhet të kenë aftësi të shprehin mendimet e tyre dhe të dëgjojnë opinionet e ndryshme, të vendosin dhe të pranojnë rregullat e grupit të punës dhe dinamikës, të jenë të gatshëm të ndihmojnë të tjerët, të bëjnë marrëveshje dhe të punojnë për të mirën e të gjithë grupit.

Aftësitë e zgjidhjes së konflikteve

— Aftësitë e zgjidhjes së konflikteve shërbejnë për të parandaluar apo për të adresuar, për të menaxhuar dhe për të zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore dhe me efikasitet. Këto aftësi mundësojnë krijimin e një mjedisi të sigurt për shprehjen e ideve dhe të mendimeve të gjithsecilit, duke rritur kështu vazhdimisht mirëkuptimin e besimin e përbashkët, si dhe krijimin e lidhjeve më të afërta dhe më të mira pas një mosmarrëveshjeje. Që të arrihet kjo, duhet të kemi aftësi të dëgjojmë dhe të kuptojmë pikëpamjet e ndryshme, të analizojmë shkaqet dhe kontekstin mbi të cilin ngrihet konflikti, si dhe të gjejmë rrugët dhe pikën e përbashkët të nisjes për zgjidhjen e tij, në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të jenë të kënaqura. Ne duhet të tregojmë se i pranojmë mendimet e ndryshme, se shumica e njerëzve dinë më shumë se një i vetëm e, së fundmi, se idetë e mira krijohen në bazë të shumëllojshmërisë së përvojave, opinioneve, ideve. Nuk kemi pse të biem dakord meoemos me gjithçka, por duhet të argumentojmë, të respektojmë njëri-tjetrin dhe të dëgjojmë opinionet e ndryshme dhe t'i analizojmë ato në mënyrë kritike.

PSE KJO ËSHTË E RËNDËSISHME PIKËRISHT TANI?

— Kalimi nga metoda e drejtpërdrejtë e mësimdhënies dhe mësimi ballë për ballë tek ato *online* në distancë, përmes përdorimit të mjeteve me bazë internetin, televizionin ose thjesht përmes dërgimit të detyrave me *e-mail* ose *Viber*, ndikon ndjeshëm në përgatitjen dhe mënyrën e strukturimit të procesit mësimor. Ky ndikim rritet shumë më tepër kur vjen puna te përvetësimi i aftësive. Aftësitë mësohen përmes modelimit, testimit dhe gabimit, pasqyrim, praktikimit dhe mbështetjes së vazhdueshme. Komunikimi virtual mund të ketë efekt të kundërt, thjesht sepse media përmes së cilës komunikojmë nuk u mundëson nxënësve në kohë reagimin nëpërmjet dialogëve, diskutimeve etj. Megjithatë, tani më shumë se kurrë, nxënësve u duhen këto aftësi, që të gjejnë rrugën e tyre në detin e informacionit dhe publikimeve

të disponueshme mediatike, si dhe të reflektojnë në mënyrë kritike mbi to, por edhe që të kuptojnë kontekstet, njerëzit, gjendjet e ndryshme emocionale dhe të komunikojnë sa më mirë me familjarët e tyre përmes mjeteve virtuale.

— Kjo pikëpamje mbështetet nga fakti se mësuesit që kanë bërë më parë përpjekje të rëndësishme për zhvillimin e këtyre aftësive të nxënësit e tyre, e kanë më të lehtë ta organizojnë procesin e mësimit në distancë. Nxënësit, që janë të pavarur dhe të aftë të gjejnë, të zgjedhin dhe të analizojnë vetë informacionin, do t'i përdorin mjetet e disponueshme dhe internetin më shpejt dhe më me efikasitet. Mësimi në këtë mënyrë do të ketë më pak nevojë për mbështetje të vazhdueshme nga mësuesit ose prindërit, ndaj botëkuptimi i nxënësve rreth asaj çfarë po ndodh rreth tyre do të bazohet më shumë mbi fakte shkencore dhe burime të besueshme.

— Komunikimi virtual ka rregullat e veta, të cilat nuk i njohin të gjithë nxënësit ose nuk janë të aftë t'i zbatojnë, prandaj mund të shkaktohen lehtësisht keqkuptime dhe konflikte. Duke mbajtur parasysh këtë, mësuesit duhet t'i ndihmojnë nxënësit të vendosin disa rregulla komunikimi, të shprehin qartë veten e tyre dhe të bëjnë pyetje të mirëformuluara. Ata nuk duhet të flasin të gjithë përnjëherësh, ndaj duhet vendosur rregulli për radhën e diskutimit dhe të pushimeve, sepse mësimi *online* nuk është i njëjtë me mësimin që zhvillohet në klasë. Gjithashtu, nxënësve u duhet shpjeguar se ky proces mësimor është zyrtar dhe duhet trajtuar si i tillë (dhe jo të shtrihen në shtrat apo diku tjetër).



IDE PËR VEPRIMTARI

— Më poshtë, jepen udhëzime apo ide për veprimtaritë që lehtësojnë zhvillimin e këtyre aftësive. Në shumë prej veprimtarive do të zbuloni se shpesh është e pamundur t'i ndani këto aftësi, pasi ato mbështesin dhe forcojnë njëra-tjetrën.

— **Mësimi i pavarur:** në vend që nxënësve t'u dërgohen vetëm leksione dhe mësimet të cilat duhet t'i lexojnë, është e rëndësishme që atyre t'u përmenden edhe strategji që të mësojnë në mënyrë të pavarur. Nëse nxënësit nuk i zotërojnë këto aftësi, ju duhet të ecni gradualisht, me hapa më të vegjël:

- ▶ Ndihmohuni nxënësit të përgatisin planin e tyre ditore dhe javor të punës. Në këto kushte, përgatitja e çfarëdolloj rutine është thelbësore, pasi ajo u jep siguri nxënësve. Të gjithë anëtarët e familjes mund të bëjnë një plan ditore, ta zbulojnë apo ta ilustronë atë dhe ta vendosin në një vend të dukshëm në shtëpi. Shumica e prindërve shkojnë në punë ose punojnë nga shtëpia, kështu që të gjithë duhet të përcaktojnë kohën për punën, për vaktet e ushqimit dhe për veprimtaritë e përbashkëta. Nxitini nxënësit t'i përmbahen planit që kanë përgatitur, por jo në mënyrë të detyruar, pasi duhen mbajtur parasysh gjendjet emocionale, nevojat e nxënësve dhe të rriturve, gjithashtu, komunikojini atyre se duhet të kenë kohë të lirë dhe se, sigurisht, është normale të kalojnë pak kohë vetëm, të bëjnë çfarë duan apo të mos bëjnë gjë fare.

- ▶ Mësuesit duhet ta nisin javën me objektiva të qartë, duke u dërguar nxënësve planin për gjithë javën, në mënyrë që ata (dhe prindërit) të kenë ndjesinë e kontrollit dhe të sigurisë, si dhe të organizojnë kohën e tyre. Plani duhet të përmbajë rezultatet e mësimit, të paraqitura në gjuhë të përshtatshme për nxënësit, si p.sh.: *këtë javë, objektivi ynë është të mësojmë, të zhvillojmë...* Objektivat mund të shprehen në mënyra të ndryshme: *në fund të kësaj jave ju do të..., do të jeni të aftë të..., do të kuptoni më mirë...* Plani i punës duhet të ketë afate për faza të ndryshme, me qëllim që nxënësit të mësohen të ndjekin ritmin e punës së tyre në mënyrë të pavarur.
- ▶ Është shumë e rëndësishme që nxënësi, përveç planit të mësimit, të vendosë edhe objektivat e tij individualë dhe, në fund të javës, të vlerësojë arritjet e tij dhe punën që ka mbetur ende për t'u bërë.
- ▶ Strategjitë e dhëna duhet t'i nxisin nxënësit të bëjnë kërkime, të ngrenë dyshime, të krahasojnë dhe të bëjnë pyetje, në mënyrë që përvetësimi i njohurive të ketë kuptim për ta. Pyetini nxënësit se çfarë u intereson, çfarë do të dëshironin të mësonin ose të kërkonin. Nëse u jepet mundësia të bëjnë këtë gjë *online*, mund të kërkojnë mbi çështje, probleme ose ngjarje të caktuara së bashku me miqtë e tyre.

■ **Besimi se secili mund të jetë varianti më i mirë i vetes së tyre:** në kushtet ku komunikimi është i kufizuar, e njëherësh jemi edhe të shqetësuar për shëndetin mendor të nxënësve, priremi të biem në kurthin e thjeshtëzimit të gjërave dhe t'u caktojmë nxënësve detyra të thjeshta, që ata mund t'i kryejnë lehtësisht. Kjo nuk duhet bërë. Edhe pse është shumë e rëndësishme mbajtja parasyshe e aftësive, nevojave dhe interesave individuale të nxënësve, duhet të vazhdojmë të kemi pritshmëri të larta dhe t'u japim atyre ndjesinë e besimit tek aftësitë e veta. Krijoni hapësirë për rritjen dhe përparimin e tyre. Detyrat nuk duhet të bazohen drejtpërdrejt te përmbajtja mësimore, por të hartohen sipas interesave që nxënësit kanë shprehur në tema apo pjesë të veçanta të mësimëve. Nxitini fëmijët të punojnë për projektet e tyre, për shembull, të monitorojnë rritjen e një bime me kalimin e kohës dhe të mbajnë shënime për këtë proces; të bëjnë një fotografi tek i njëjti vend çdo ditë për të mbikëqyrur ndryshimet; të mbajnë ditarin e fotografive të tyre ose të shkruajnë një gazetë apo *blog*; të bëjnë librin e tyre të gatimeve me recetat që kanë gatuar vetë; të mbajnë statistika dhe të bëjnë llogaritje më të komplikuar statistikore lidhur me numrin e personave të infektuar me koronavirus. Kjo do t'i motivojë ata të mësojnë në mënyrë të pavarur, pa pasur frikë se do të bëjnë gabime.

■ **Përdorimi i burimeve të besuara:** për shumë detyra, kërkojuni nxënësve të marrin informacione nga interneti. Gjithmonë kërkojuni të kontrollojnë burimin; aftësinë apo formimin e autorit; të krahasojnë burime të ndryshme; të japin tregues statistikorë, fakte, citime...

■ **Përdorimi i argumenteve:** jepuni nxënësve detyra/çështje për të cilat duhet mbajtur një qëndrim dhe duhet shprehur këndvështrimi dhe argumentimi i tyre dhe/ose arsyetimi logjik: *Cili është këndvështrimi juaj?; Si dolët në atë përfundim?; Shpjegoni mënyrën se si arritët në atë përfundim...* Çështjet mund të jenë: *Sjellja e njerëzve gjatë pandemisë do të ndikojë pozitivisht në mjedisin natyror... ose Çfarë ndikimi ka pandemia mbi mjedisin, a ka lidhje ajo me ndryshimin klimatik, të drejtat e njeriut... etj.*

■ **Të menduarit në një nivel më të lartë:** nxitini dhe caktojuni nxënësve detyra që do t'i vënë ata në punë për të gjetur përgjigje, por bëjuni edhe pyetje të një niveli më të lartë: *Pse mendoni se...; Si do të ndikojë kjo...; Çfarë... lidhur me; ... Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet...; Ku mund të gjeni një shembull të ngjashëm...; Cili është shkaku...; Po pasoja...; Çfarë do të kishte ndodhur nëse... etj.*

■ **Bashkëpunimi me të tjerët:** nxitini nxënësit t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit ose të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për probleme të caktuara. Ndonëse komunikimi është i vështirë, bashkëpunimi i ndërsjellë mes nxënësve është i domosdoshëm, që ata të ndihen se janë ende pjesë e grupit të bashkëmoshatarëve të tyre. Nxitini ata të mendojnë se kujt tjetër, përveç mësuesve, mund t'i drejtojnë pyetjet. Kërkojuni nxënësve të mendojnë se me kë do të dëshironin të flisnin, për çfarë do të donin të flisnin dhe se si mund ta kontaktojnë atë person. Mësojuni të mendojnë jashtë kornizave.

■ **Përdorimi i fakteve:** ndihmojuni nxënësit të dallojë faktet nga opinionet. Dërgojuni atyre një tekst ose një artikull dhe caktojuni si detyrë të gjejnë deklaratat që pasqyrojnë mendimin e dikujt dhe ato që janë të bazuara në fakte. Më pas, ata mund të kërkojnë raporte mediatike dhe të nxjerrin shembuj opinionesh dhe faktesh. Kërkojuni nxënësve të shkruajnë vetë një artikull mediatik dhe t'i shkëmbejnë me njëri-tjetrin për t'i analizuar dhe për t'i kontrolluar.

■ **Mësimdhënia online në vende të tjera:** jepuni si detyrë nxënësve të kërkojnë se si mësojnë nxënësit në shtetet e tjera. Kërkojuni secilit nxënës të zgjedhë një shtet që i intereson, të shikojë se çfarë po ndodh në këtë vend, të hulumtojë e të mësojë rreth tij, duke përdorur *Google Translate*. Në bazë të të dhënave që kanë marrë, ata mund të tregojnë si i jetojnë nxënësit këto kohë në atë vend. Nëse keni mundësi, kontaktoni mësuesit në një shtet tjetër dhe dërgojuni atyre një letër mbështetjeje ose shkëmbeni informacione. Tani, më shumë se kurrë, nxënësit duhet ta kuptojnë se jemi të gjithë banorë të planetit Tokë.

■ **Këndvështrime të ndryshme:** kërkojuni nxënësve të analizojnë një problem ose gjendjen aktuale, sipas këndvështrimeve të njerëzve të moshave të ndryshme, profesioneve, gjinive, vendeve dhe mënyrave të ndryshme të jetesës. Ata mund të bëjnë një intervistë *online* me një gjyshe, me dikë që punon në një dyqan ose me një mësues/e. Gjithashtu, mund ta redaktojnë dhe ta botojnë intervistën ose mund të shkruajnë një histori në vetën e parë, rreth mënyrës se si ndihet personi, çfarë mendon ai/ajo, për çfarë shqetësohet ai/ajo, çfarë pëlqen të bëjë ai/ajo etj.

■ **Kërkimi:** kërkojuni nxënësve të bëjnë një studim për të zbuluar më shumë për mënyrën se si jetojnë bashkëmoshatarët e tyre, nxënësit më të rritur ose më të vegjël, në qytetin e tyre ose në mbarë vendin. Ata mund të bëjnë një pyetësor elektronik, pasi të kenë hartuar me kujdes pyetjet dhe pasi t'i kenë testuar ato në klasën e tyre. Më pas, kërkojuni mësuesve ose prindërve t'i postojnë në rrjetet sociale ose dërgojuni me e-mail në adresë të ndryshme. Nxënësit më të rritur mund të mësojnë të krijojnë hipoteza dhe të formulojnë pyetje kërkimore.

■ **Ne komunikojmë:** krijoni sistemin tuaj simbol të komunikimit me nxënësit – kërkojuni atyre që të sugjerojnë simbole ose ikona të reja, madje edhe fjalë që do

të kenë kuptim të veçantë vetëm për ata. Dërgojini njëri-tjetrit mesazhe argëtuese dhe të bukura, duke përdorur fjalët dhe simbolet që keni krijuar.

■ **Rregullat:** vendosni rregulla të përbashkëta për komunikimin *online* – fjalët që përdorim, mënyra si i drejtohem njëri-tjetrit, kur dhe sa shkruajmë. Mund të flisni, gjithashtu, për pasojat e shkeljes së këtyre rregullave: *Si ndikon kjo tek të tjerët; pse?; Çfarë mund të bëjmë?* Komunikimi *online* ka veprimtari argëtuese, për shembull, një herë në javë mund të vishemi sipas një teme të caktuar gjatë një takimi *online*.

■ **Emocionet tona:** flisni me nxënësit për emocionet. Ato mund të shprehen me ngjyra duke iu përgjigjur pyetjeve: *Cila është ngjyra që tregon emocionin e tyre aktual? Në cilën pjesë të trupit e ndiejnë atë? Cilat janë mënyrat e trajtimit të tyre? Çfarë do t'i këshillonin njëri-tjetrit kur kalojnë kohë të vështira?* Ata mund të vizatojnë formën e një trupi dhe të ngjyrosin me ngjyrat e caktuara pjesët ku ndiejnë emocionet dhe, pas kësaj, mund të flasin rreth tyre. Caktoni një ditë për mesazhet e bukura – kërkoni të shkruajnë emrin e një shoku/shoqeje të shkollës, të cilit/cilës do t'i dërgojnë mesazhe atë javë.

KREU 4:

NJOHURITË DHE TË KUPTUARIT KRITIK



PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË FLASIM RRETH NJOHJES DHE TË KUPTUARIT KRITIK?

Termi *njohje* ose *njohuri*, i futur në bisedat tona të përditshme, mund të përkufizohet dhe të kuptohet në mënyra të ndryshme. Shpesh, kuptohet si njohje e informacioneve dhe fakteve të caktuara, ndonjëherë duke iu referuar njohurive praktike dhe jo thjesht atyre teorike, ose mund të jetë shkrimi dhe të dyjave, për sa i përket njohjes dhe kuptimit të të dhënave, informacionit, përshkrimeve, koncepteve etj., që përftohen përmes mësimit dhe përvojës. Për ta përkufizuar më qartë këtë term, përveç njohjes do të flasim edhe rreth të kuptuarit kritik, që nënkupton qëndrimin kritik ndaj të dhënave që marrim dhe përftojmë, ndaj pasqyrit dhe vlerësimit.

- Njohja dhe të kuptuarit kritik e vetes
- Njohja dhe të kuptuarit kritik e gjuhës dhe komunikimit
- Njohja dhe të kuptuarit kritik e botës: politikat, ligji, të drejtat e njeriut, kultura, kulturat, fetë, historia, media, ekonomitë, mjedisi dhe qëndrueshmëria

Njohuritë dhe të kuptuarit kritik

Njohja dhe të kuptuarit kritik e vetes

— Kjo kompetencë përfshin njohuritë dhe të kuptuarin kritik të mendimeve, besimeve, ndjenjave, motivimeve, përkatësive dhe perspektivës sonë kulturore në botë.

— Për të qenë pjesëmarrës aktiv dhe krijues i kulturës së demokracisë, duhet të dimë dhe të kuptojmë gjithçka që formon identitetet tona dhe mënyrat përmes të cilave formësohen ato. Dhe këtu kemi parasysh marrëdhënien tonë me një kulturë ose me një përvojë të veçantë, me besime apo mendësi të trashëguara apo të mësuara, me njohuritë tona, si dhe me kufizimet tona etj., e sërish kjo nuk është gjithçka.

Njohja dhe të kuptuarit kritik e gjuhës dhe komunikimit

— Kjo kompetencë përfshin njohuritë dhe të kuptuarit kritik të shenjave verbale dhe atyre joverbale të komunikimit, në një shoqëri të caktuar, që funksionon përmes gjuhës që flasin anëtarët e saj. Kjo kompetencë lidhet me aftësinë që ka çdo gjuhë për të shprehur kuptime të njëjta në mënyra unike, po aq sa dhe me efektet që kanë mënyrat e ndryshme të komunikimit tek të tjerët.

— Kjo nënkupton të qenit të hapur ndaj shenjave të ndryshme në komunikim, duke kuptuar se ato ekzistojnë si mënyra të shkëmbimit të informacioneve në një kulturë të veçantë, por, njëkohësisht, mund të shkaktojnë edhe konflikte për shkak të keqkuptimeve, sepse gjuha është mjet i fuqishëm që ndikon në formësimin e mendimeve tona.

Njohja dhe të kuptuarit kritik e botës: politikat, ligji, të drejtat e njeriut, kultura, kulturat, fetë, historia, media, ekonomitë, mjedisi dhe qëndrueshmëria

— Kjo kompetencë përfshin një sferë të gjerë dhe komplekse njohurish, pra, të kuptuarin e një shumëllojshmërie fushash, ku bëjnë pjesë politika, ligji, të drejtat e njeriut, kulturat, fetë, historia, media, ekonomitë, mjedisi dhe qëndrueshmëria.

— Njohja e politikës dhe e ligjit përfshin shumë koncepte, si: demokracia, liria, drejtësia, barazia, si dhe mënyrën e funksionimit të proceseve dhe të institucioneve demokratike. Qytetarët dhe shoqëria civile luajnë rolin e vet në zhvillimet aktuale dhe marrëdhëniet me botën, marrëdhëniet e pushtetit dhe pengesat në rrugën e ndërtimit të një shoqërie demokratike.

— Kur vjen fjala tek të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është e nevojshme të kuptohen të drejtat e njeriut, si funksionojnë ato brenda shoqërive dhe shteteve, detyrimet e shteteve palë, si mbrohen apo si shkelen ato, cilat janë detyrat e shtetit dhe të secilit prej nesh, kufizimet e të drejtave tona. Gjithashtu, është e rëndësishme të kuptohet se të drejtat e njeriut u përkasin njerëzve, i përkasin çdokujt, pavarësisht dallimeve mes nesh (pa diskriminim), ndërsa disa të drejta u përkasin vetëm disa individëve (për shembull, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara/veçanta, të drejtat e anëtarëve të minoriteteve kombëtare), në mënyrë që të mund të arrihet barazia njerëzore.

— Me njohjen e kulturave kuptojmë mënyrën se si këto kultura ndikojnë në sjelljen tonë, si i japin formë besimeve dhe vlerave tona. Studimi i kësaj fushe, po ashtu, duhet të na mësojë se çdo individ është unik e i veçantë dhe se marrëdhënia e tyre me një kulturë të caktuar nuk i përkufizon plotësisht ato, nga ana tjetër, njohja e kulturës së tyre është thelbësore për arritjen e kuptimit të ndërsjellë. E njëjta gjë vlen edhe për rastin e njohjes dhe të kuptuarit kritik të besimeve të ndryshme, të traditave fetare, simboleve, ritualeve, shkrimeve e dokumenteve, si dhe të gjuhëve të ndryshme.

— Studimi i historisë na ndihmon të kuptojmë ngjarjet e faktorët e ndryshëm, që kanë formuar botën bashkëkohore, duke mundësuar përdorimin e burimeve të ndryshme të informacionit, të perspektivave të ndryshme dhe me vetëdijen e mundësive interpretuese të ndryshme për ngjarjet historike.

— Media luan një rol veçanërisht të rëndësishëm në botën bashkëkohore, ndaj është e nevojshme të fitohen sa më shumë njohuri dhe të kuptuarit kritik mbi mënyrat e funksionimit të medieve të ndryshme, ndikimeve që kanë ato te ne dhe te shoqëria, manipulimi dhe keqpërdorimi i medias, si dhe rëndësia e medieve publike të pavarura.

— Ekonomia është forca drejtuese e shoqërisë dhe, që demokracia të funksionojë, duhet të njihet mënyra e funksionimit të saj, parimet kyçe, ndikimet në mjedis, sot dhe në të ardhmen, si dhe ndikimet e saj mbi dallimet mes njerëzve.

PSE KJO ËSHTË E RËNDËSISHME PIKËRISHT TANI?

— Çdo situatë na jep mundësi të mësojmë diçka prej saj dhe rasti i pandemisë i ndihmon nxënësit të kuptojnë se si lidhet dhe organizohet e gjithë bota dhe pse njohja dhe të menduarit kritik i aspekteve të ndryshme dhe i mënyrave të funksionimit të botës janë të rëndësishme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, pasi ne mund t'u ofrojmë nxënësve mjetet, por edhe t'u krijojmë atyre ndjeshmërinë se bota ka ndryshuar dhe se brezat e tyre kanë mundësi ta bëjnë atë më të mirë.

— Që të mendojmë në mënyrë kritike, të analizojmë dhe të zgjidhim problemet, duhet të kemi njohuri. Kalimi te mënyrat moderne të mësimdhënies, ndonjëherë është keqinterpretuar, duke theksuar përvetësimin e aftësive pa analizën e thellë të fakteve. Ndonëse nuk mund të marrim të gjitha njohuritë e kësaj bote, hapi i parë i gjetjes së përgjigjes për pyetje të posaçme, është përftimi dhe kuptimi kritik i të dhënave, fakteve dhe informacionit. Edhe gjatë një pandemie botërore, është e qartë sa e qëndrueshme është dija shkencore, por është e qartë, gjithashtu, se si manipulohet apo përdoret ajo për interesa të veçanta politike e ekonomike. Vullneti për të mësuar dhe për të kërkuar informacione të besueshme, bashkë me të kuptuarit e mënyrës së funksionimit të medias, shoqërive dhe ekonomive, po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme.



IDE PËR VEPRIMTARI

— Siç u përmend edhe më sipër, mësimdhënia cilësore është një proces pothuajse paralel i marrjes së njohurive, zhvillimit të aftësive dhe përshtatjes së vlerave e qëndrimeve. Më poshtë jepen disa ide për veprimtari, që përqendrohen në marrjen e njohurive dhe të kuptuarin kritik.

— **Pyetje reflektuese:** të mësuarit nuk është rezultat i leximit të mësimëve apo i teksteve që jep mësuesi/ja si detyrë. Të mësuarit është një proces që ndodh natyrshëm, si nevojë që lind për t'iu përgjigjur një pyetjeje ose për të zgjidhur një problem të veçantë. Prandaj, që nxënësit të marrin njohuri, duhet të ndihmohen të identifikojnë problemin që duan të zgjidhin. Për shembull, problemi mund të jetë: *Në disa shtete ndalohet plotësisht dalja e nxënësve nga shtëpia. Ato kanë vendosur t'ju caktojnë juve si avokat për ta shfuqizuar këtë dispozitë. Cilat do të ishin argumentet tuaja? Cilin do të kontaktonit? A ka ndonjë provë për këtë në dokumentacionet ndërkombëtare? Si do ta zgjidhje këtë problem?*

— Për këtë, duhet që nxënësit të shqyrtojnë, p.sh., Deklaratën për të Drejtat e Fëmijëve, institucionet përkatëse që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe të nxjerrin përfundime logjike.

— **Cili është roli i organizatave ndërkombëtare:** kjo është koha e duhur që nxënësit të mësojnë se si veprojnë organizatat në mbarë botën, të mësojnë funksionin dhe rolin e tyre. Mund të filloni duke kërkuar për Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), Këshillin e Evropës (KE) ose Bashkimin Evropian (BE). Kërkojuni nxënësve të gjejnë se cili/cila mund ta shpallë gjendjen e një pandemie dhe çfarë nënkupton ajo. Si ndikon kjo në botë? Cili/cila mund të ndihmojë në trajtimin e pasojave ekonomike të një pandemie? Pse na duhen organizata në nivel botëror?

— **Unë si anëtar i një ekipi emergjence:** nxitini nxënësit të imagjinojnë sikur janë anëtarë të një ekipi emergjence, në luftën kundër pandemisë. Kush i caktoi ata në këtë rol? Cilat janë kompetencat e tyre? Kujt i raportojnë? Kërkojuni të bëjnë planin e veprimtarisë së ekipit të emergjencës për lagjen e tyre. Cilët do të përfshinin në këtë ekip dhe pse? Si mund t'i mbrojnë ata interesat e njerëzve të ndryshëm (grave, të rinjve, të moshuarve...)? Çfarë veprimesh do të ndërmerrenit? Çfarë nevojitet për kryerjen e këtyre veprimeve? Si do të siguronit gjithçka që ju duhet? Si do të vendosnit për zbatimin e planit?

— **Për Kushtetutën:** së fundmi, mund të dëgjoni se ndalimi i lëvizjes së qytetarëve është një vendim jokushtetues – çfarë do të thotë kjo? Analizoni nenet e Kushtetutës dhe jepni arsyetimin tuaj ligjor.

— **Ligji dhe drejtësia:** dërgojuni nxënësve tuaj fotografinë e statujës së drejtësisë (lat. *Justitia*) dhe kërkojuni ta vështrojnë me vëmendje. Çfarë tregon fotografia, çfarë mban në duar gruaja? Si mund ta lidhni me konceptin e drejtësisë? Flisni për shaminë me të cilën ajo ka mbyllur sytë, për shpatën dhe për peshoren – çfarë përfaqësojnë

ato dhe pse? Çfarë simboli do të përdornit për të përshkruar drejtësinë? Krijoni simbolin tuaj të drejtësisë.

- ▶ Pse statuja e drejtësisë është një grua? Shkruani një ese për atë që mendoni.
- ▶ Sipas mendimit tuaj, a janë sinonime ligji dhe drejtësia? Krahasoni dy termat dhe, në dy rrahë që mbivendosen (diagrami i Venit), shënoni ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre. Merrni një shembull nga jeta reale, kur një vendim i marrë ka qenë i ligjshëm (i vendosur në përputhje me ligjin/drejtësinë), por mund të mos ketë qenë i drejtë. Çfarë do të kishte qenë e drejtë?
- ▶ Si bëhen ligjet? Formuloni disa dispozita legjislatve që do të donit të zbatoheshin pas përfundimit të pandemisë, duke marrë parasysh përvojat tuaja. Zbuloni mënyrën si hartohen dhe shkruhen ligjet. Merrni një dispozitë legjislatve që e konsideroni interesante dhe shpjegoni pse. Mendoni për ndryshimet që duhen bërë në ligj dhe thoni pse duhen bërë.

■ **Po sikur:** në vend që t'u mësoni nxënësve sistemin e qeverisë, kërkojuni atyre të zgjedhin një institucion dhe të shkruajnë se çfarë do të ndodhte nëse ai institucion nuk do të ekzistonte. Çfarë pasojash do të kishte?


■ **Imagjino:** kërkojuni nxënësve të dëgjojnë këngën *Imagine (Imagjino)*, të Xhon Lenonit, të shkruajnë tekstin e përkthyer në anën e majtë të një blloku ose fletoreje, të vizatojnë një vijë vertikale dhe, nga ana e djathtë, të shkruajnë atë që mendojnë për secilin varg dhe se cilat mendime i frymëzojnë. A bien dakord apo jo me tekstin e këngës? Kërkojuni të shpjegojnë këndvështrimin e tyre.

■ **Ekonomia:** nxitini nxënësit të analizojnë pasojat e mundshme ekonomike të pandemisë në një degë të ekonomisë, për shembull, në turizëm apo në transportin ajror, në bujqësi apo transportin rrugor. Përcaktoni të gjitha degët e tjera të ekonomisë që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë me degën që keni zgjedhur fillimisht, më pas degët e tjera të ekonomisë që lidhen me degën e dytë. Analizoni se deri ku mund të shkojnë pasojat dhe ndikimet. Si mund të përshtatet kjo degë me situatën e re?

■ **Pandemia përmes historisë:** nxitini nxënësit të analizojnë pandemitë më të mëdha në historinë njerëzore. Kërkojuni të zgjedhin një pandemi dhe të gjejnë informacionet kryesore për të: shpërndarjen në hartë, numrin e njerëzve të prekur, ndikimin në shoqëri dhe zbulimet shkencore që ndihmuan në ndalimin e saj.

■ **Kush po e ndryshon botën?** Nxitini nxënësit të gjejnë njerëz që mendojnë se e kanë ndryshuar botën për mirë dhe se kanë siguruar respektimin e disa të drejtave të caktuara njerëzore. Objektivi për klasën është zgjedhja e pesëdhjetë personaliteteve më të mëdha. Krijoni një komitet dhe përcaktoni kriteret e përzgjedhjes. Kërkojuni të gjithëve të përgatitin profilin e një ose dy njerëzve dhe të shpjegojnë arsyet se pse ai/ajo duhet të jetë në këtë listë. Merrni parasysh barazinë gjinore dhe sigurohuni që burrat dhe gratë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë.

■ **Festat fetare:** gjatë pandemisë, disa festa fetare do të kremtohen në të gjithë globin. Gjejini se cilat janë këto festa dhe bëni një përshkrim të shkurtër për secilën prej tyre. Shpjegoni emrin e festës, mesazhin, traditat etj. Bëni një përmbledhje të festave fetare gjatë pandemisë, por jo thjesht duke u përqendruar te festat e mëdha, që kremtohen në vendin ose në mjedisin ku jetoni.



Ky manual është krijuar në një kohë që nuk ngjason aspak me kohën që kemi njohur ne apo fëmijët tanë, në një çast kur rrugët dhe shkollat janë boshatisur, kur jeta është mbushur me frikë e pasiguri dhe kur sytë i kemi pasur të mbërthyer pas ekraneve televizive dhe rrjeteve sociale. Kjo është gjithashtu koha, kur më shumë se kurrë më parë, shumë njerëz po mendojnë edhe një herë për qëndrimet dhe për vlerat e tyre, si dhe për dijet dhe aftësitë.

Manuali flet pikërisht për këtë – qëndrimet dhe vlerat që duhet të kemi për ta ruajtur këtë botë si një vend të cilit i përkasim që të gjithë njëlloj, ku ndihemi të respektuar dhe të mbrojtur dhe ku lidhemi së bashku në komunitete të forta, të gatshëm për t'u përballur me çdo sfidë që na pret.

SQI

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE